


-III- Nr. i prot. 2754 Më
Br. prot. Dt. 05.09.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATEË

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KOMUNA E RAHOVECIT**, në njëren anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: N.T.P. “EGZONI” me adresë në Ferizaj, të cilën e përfaqëson Zemrae Nuha

Janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

TITULLI I KONTRATËS: FURNIZIM ME MATERIAL USHQIMOR

Numri i Prokurimit: 623-19-5096-1-3-6

Numri i Brendshëm: 623-19-038-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizim me material ushqimor**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë prej 12 Muaj.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [3-5] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë: **Në Komunën e Rahovecit**.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **7,777.00 Euro;**

(**Shtatëmijë e shtatëqindeshatatëdhjeteshtatë Euro e zero zero Cent).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkeshat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktuje pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njofjojë Operatorin Ekonomik përvendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmon ton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimeshit nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip]² në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues:	
Emri:	Zemrae Nuha	Emri:	Astrit Mullabazi
Pozita:	Drejtësor	Pozita:	U.d. Menaxher i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.09.2019	Data:	05.09.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Specifikacion: Furnizim me material Ushqimor

Çmimi i artikujve duhet të jetë konformë të gjitha tregimeve dhe detyrimeve në Republikën e Kosovës

Nr.	Lloji i materialit	Njësia	Sasia e përafërt e planifikuar	Çmimi për njësi	Totali
1	Pjekurina (Bambi-Mix) - ose ekujivalent	cope	200.00	0.95	190.00
2	Pije e gazuar 2L (Coca Cola)- ose ekujivalent	cope	200.00	1.30	260.00
3	Pije e gazuar 0,33 L (Coca Cola) - ose ekujivalent	cope	250.00	0.45	112.50
4	Patatina (Chips) 150 gr. - ose ekujivalent	cope	200.00	0.90	180.00
5	Pije e gazuar 2L (Fanta) - ose ekujivalent	cope	200.00	1.30	260.00
6	Pije e gazuar 0.33 L (Fanta) - ose ekujivalent	cope	250.00	0.45	112.50
7	Gota plastike 100 cope	garniture	250.00	0.80	200.00
8	Kaffe 500 gr.	cope	20.00	4.20	84.00
9	Kaffe për ekspreso 1kg	cope	120.00	5.60	672.00
10	Kaffe Ness 250 gr. - Ekuvalente	cope	45.00	4.50	202.50
11	Kikiriki 500 gr.	cope	50.00	2.50	125.00
12	Lengje pemesh 1L (tetrapak)	cope	250.00	0.70	175.00
13	Luge plastike 100 cope	cope	100.00	1.50	150.00
14	Uje mineral 2 L	cope	100.00	0.40	40.00
15	Uje mineral 0.5 L	cope	800.00	0.25	200.00
16	Uje natyral 0,5 L	cope	12,000.00	0.20	2,400.00
17	Uji natyral 0.25 L (ambalzhim qelqi)	cope	500.00	0.40	200.00
18	Uji mineral 0.25 L (ambalzhim qelqi)	cope	200.00	0.30	60.00
19	Pjata plastike -1 tub -50 copa	cope	100.00	1.20	120.00
20	Qaj nana Filter	cope	240.00	0.40	96.00
21	Qaj kamomil Filter	cope	240.00	0.40	96.00
22	Qaj Hibiskus Filter	cope	240.00	0.40	96.00
23	Qumsht (tetrapak) 1L	cope	420.00	1.10	462.00
24	Qumsht Pluhur 400 gr.	cope	30.00	0.95	28.50
25	Sheqer koker 1 kg	kuti	120.00	1.00	120.00
26	Sheqer i paketuar për ekspreso 3 kg	pako	150.00	2.00	300.00
27	Pije e gazuar 1,5 L (Shwepes) ose ekujivalent	cope	200.00	1.30	260.00
28	Pile e gazuar 0,33 L (Shwepes) ose ekujivalent	cope	250.00	1.30	325.00
29	Shkopinj 50gr.	cope	250.00	0.20	50.00
30	Shkopinj 250gr.	cope	200.00	0.80	160.00
31	Smoki 50gr.	cope	200.00	0.20	40.00
				Totali:	37,95
				7,777.00	

